



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1725/10 prot

Datë 29.09.2023

V E N D I M

Nr. 978/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.09.2023 shqyrtoi ankesën me:

- Objekti:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Kristalina.KH” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar,” me nr REF-72907-06-19-2023 me objekt “Shpenzime per Shtypshkrime te Regjistrave te Mjekut 2023” me fond limit 2,045,331.8 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 03.07.2023 nga autoriteti kontraktor Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Inpres” SHPK me NIPT: L52122014L dhe me adresë: *Ish Blloku i Magazinave të Tregtisë, Rruga “Siri Kodra”, Tiranë.*
- Autoriteti Kontraktor:** Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
Adresa: Rr. “Sami Frashëri”, nr. 8, Tiranë
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “Kristalina.KH” SHPK
Adresa: Rr.Lord Bajron,Laprake ,Tirane
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Neni 4, i Vendimit të

Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020
“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin
e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit
Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -
19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesve dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorit ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 20.06.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar,” me nr REF-72907-06-19-2023 me objekt “Shpenzime per Shtypshkrime te Regjistrave te Mjekut 2023” me fond limit 2,045,331.8 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 03.07.2023 nga autoriteti kontraktor Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

II.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit më datë 03.07.2023 dhe në datën 06.07.2023, ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave përkatësisht:

“Kristalina-KH” SHPK	me ofertë	1.678.700 lekë	kualifikuar
“Expo Vision Albania” SHPK	“	1.847.109,40 lekë	skualifikuar
“Filara” SHPK	“	1.860.204 lekë	skualifikuar

II.3. Më datë 13.07.2023 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin paraprak të fituesit.

II.4. Në datën 18.07.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3279 dhe me nr. 1725/2023 protokollin datë 18.07.2023 e operatorit ekonomik “Inpres” SHPK për procedurën e prokurimit “*E hapur e thjeshtuar,*”, me nr REF-72907-06-19-2023 me objekt “*Shpenzime per Shtypshkrime te Regjistrave te Mjekut 2023*” me fond limit 2,045,331.8 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 03.07.2023 nga autoriteti kontraktor Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Kristalina.KH” SHPK.

II.5 Bazuar në nenin 112 pika 4 të ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1725/2 prot., datë 19.07.2023, u publikuan pretendime të ankimuesit mbi vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në procedurën e prokurimit sipërcituar.

II.6. Në datën 20.07.2023 operatori ekonomik “Kristalina.KH” SHPK, ka dprëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Formularin e paraqitjes së argumentave, protokolluar me tonën me nr. 1725/3 prot., datë 20.07.2023.

II.7. Autoritet Kontraktor me shkresën nr. 1160/24 prot., datë 24.07.2023, protokolluar me tonën me nr. 1725/4 prot., datë 25.07.2023, ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës, lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke njoftuar vendimin e KSHA-së për mospranim të ankesës.

II.8. Me shkresën Nr. 1725/5 prot., datë 04.08.2023, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nisur nga pretendimet e paraqitura nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK, ka kërkuar autoritetin kontraktor të dorëzojë pranë KPP-së, mostrat e paraqitura për këtë procedurë prokurimi nga operatorët ekonomikë “Kristalina-KH” SHPK, si dhe dokumentacionin shoqërues të tyre.

II.9. Me shkresën nr. 1160/26 prot., datë 11.08.2023, protokolluar me tonën me nr. 1725/6 prot., datë 11.08.2023, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dorëzoi mostrat e kërkuara, së bashku me dokumentacionin shoqërues pranë KPP-së.

II.10. Më datë 29.08.2023, Komisioni i Prokurimit Publik mori Vendimin e ndërmjetëm me Nr. 830/2023 datë 29.08.2023 dhe nr. 1725/7 prot., “Mbi testimin e mostrave të dorëzuara

nga operatori ekonomik “Kristalina-KH” SHPK, pranë laboratorit testues të akredituar “Eko-Studio-Projekt” SHPK.

II.11. Më datë 04.09.2023 në vijim të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 830/2023 datë 29.08.2023, në prani të anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik u mbajt Seanca dëgjimore me pjesëmarrjen e të gjitha palëve, ku përfaqësuesit e “Kristalina-KH” SHPK kryen verifikimet e mostrave të dorëzuara të cilat do të dorëzohen pranë laboratorit testues.

Përfaqësuesja e OE “Inpress” SHPK dorëzoi mandat-pagesën për testimet me nr. 1725/8 prot., datë 04.09.2023, për llogari të laboratorit testues “Eko-Studio-Projekt” SHPK.

II.12. Më datë 04.09.2023, u vijua me dorëzimin e mostrave për testim pranë laboratorit “Eko-Studio-Projekt” SHPK, ku u mbajtën Formularët e Aplikimit pranë laboratorit.

II.13. Pranë Komisionit të Prokurimit Publik jnaë ë depozituar shkresat me nr. 716 prot., datë 14.09.2023, nr. 717 prot., datë 14.09.2023, nr. 718 prot., datë 14.09.2023, nr. 719 prot., datë 14.09.2023, nr. 720 prot., datë 14.09.2023, nr. 721 prot., datë 14.09.2023, nr. 722 prot., datë 14.09.2023, nr. 723 prot., datë 14.09.2023, nr. 724 prot., datë 14.09.2023, nr. 725 prot., datë 14.09.2023, nr. 726 prot., datë 14.09.2023, nr. 727 prot., datë 14.09.2023, nr. 728 prot., datë 14.09.2023, nr. 729 prot., datë 14.09.2023, nr. 730 prot., datë 14.09.2023, e “Eko-Studio-Projekt” SHPK me anë të së cilës përcjell “Raport-Testim”, mbi rezultatet e testimit të mostrave.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK, për mospërbushje nga operatori ekonomik “Kristalina.KH” SHPK të kriterit 3.4 me pretendimin si vijon: “Së Pari, Në kundërshtim me pikën 3.4 “Aftësitë teknike dhe profesionale për makineritë”, të shtojcës 7, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST, ku përcaktohet se: “4. Operator Ekonomik duhet të disponojë makineritë:

o Makinë shtypi, makinë qepëse me tel, makine palosëse

o Binder

o Linjë për përgatitjen e lastrave- CTP

o Thikë treanëshe.

Për të vërtetuar disponimin e këtyre makinerive operatorët ekonomik duhet të paraqesin fatura tatimore, zhdoganimin ose kontrata e qiraje të lidhura para noterit, me afat për periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi, e shoqëruar me dokumentacion që provonë pronësinë e qiradhënësin.”

Ne shprehim bindjen tonë, që OE Kristalina KH shpk. NUK disponon realisht makinerinë / pajisjen Linjë për përgatitjen e lastrave (CTP).

.....

Kërkojmë nga KSHA e AK dhe KPP, që përpara marrjes së një vendimi të arsyetuar mbi këtë pikë të ankesës, të verifikojnë zyrtarisht disponimin e kësaj makinerie / pajisje pranë ambjentëve të shtypshkronjës të OE Kristalina KH shpk. Rrjedhimisht, OE Kristalina KH shpk. do të duhet të skualifikohet nga KSHA e AK dhe KPP, pasi nuk përmbush kriterin teknik të përcaktuar në pikën 2.3 “Aftësitë teknike dhe profesionale për makineritë, të shtojcës 7, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST, pasi nuk disponon makinerinë / pajisjen Linjë për përgatitjen e lastrave (CTP) të kërkuar në DST.”. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1 Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik” pika 2.3.4 të dokumentave të tenderit të modifikuara rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar si vijon:

“4.Operator Ekonomik duhet të disponojë makineritë:

- *Makinë shtypi, makinë qepëse me tel, makine palosëse*
- *Binder*
- *Linjë për përgatitjen e lastrave- CTP*
- *Thikë treanëshe*

- *Për të vërtetuar disponimin e këtyre makinerive operatorët ekonomik duhet të paraqesin fatura tatimore, zhdoganimin ose kontrata e qiraje të lidhura para noterit, me afat për periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi, e shoqëruar me dokumentacion që provonë pronësinë e qiradhënësin.”.*

III.1.2. Nga shqyrtimi i ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*Kristalina.KH*” SHPK, lidhur me makinerinë objekt-ankimimi, rezulton se është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:

1. *Deklaratë doganore të importit të noterizuar (R 7045) datë 01.02.2020, me përshkrimin malli: “Makineri printimi me shtypje me germa, ushqyer me cilindër, perjashtë, Makineri për përgatitje lastrash CTP (Linjë e kompletuar-Computer to plate)”.*

III.1.3. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikohet shprehimisht se:

1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.1.4. Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet

asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.1.5. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 5/ç e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet se:

“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: [...] ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”.

III.1.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit sa më sipër, të dorëzuar nga operatori ekonomik “Kristalina.KH” SHPK, rezulton se ka dorëzuar në Sistemin Elektronik të Prokurimit (SPE) edhe dokumentacionin konkret që e vërteton disponimin e kësaj pajisje, pra Deklaratën doganore të importit të noterizuar (R 7045) datë 01.02.2020.

III.1.8. Në lidhje me pretendimin e ankimesit se: “... Kërkojmë nga KSHA e AK dhe KPP, që përpara marrjes së një vendimi të arsyetuar mbi këtë pikë të ankesës, të verifikojnë zyrtarisht disponimin e kësaj makinerie / pajisje pranë ambjentëve të shtypshkronjës të OE Kristalina KH shpk. Rrjedhimisht, OE Kristalina KH shpk. do të duhet të skualifikohet nga KSHA e AK

dhe KPP, pasi nuk përmbush kriterin teknik të përcaktuar në pikën 2.3 “Aftësitë teknike dhe profesionale për makineritë, të shtojcës 7, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST, pasi nuk disponon makinerinë / pajisjen Linjë për përgatitjen e lastrave (CTP) të kërkuar në DST., rezulton se:

Për plotësimin e kriterit të kërkuar për “Linjë për përgatitjen e lastrave- CTP” operatori ekonomik “Kristalina.KH” SHPK ka paraqitur “Deklaratën doganore të importit të noterizuar (R 7045) datë 01.02.2020” e vërtetuar nga noteri publik i cili vërteton se shoqëria “Kristalina.KH” SHPK ka importuar dhe paguar detyrimet tatimore për produktin “Makineri printimi me shtypje me germa, ushqyer me cilindër, perjashto, Makineri për përgatitje lastrash CTP (Linjë e kompletuar-Computer to plate)”, duke vërtetuar se operatori ekonomik “Kristalina.KH” SHPK ka në pronësi makinë printimi të “Makineri për përgatitje lastrash CTP (Linjë e kompletuar-Computer to plate)”.

Nga sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se ofertuesi “Kristalina.KH” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.4 të Shtojcës 7 të dokumentave të tenderit.

Për sa më lart, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK nuk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK, për mospërmbushje nga operatori ekonomik “Kristalina.KH” SHPK të specifikimeve teknike të mostrave: “Në pikën 2.3.5 të kriterëve të veçanta të kualifikimit është kërkuar - 5.Për të gjithë artikujt e ofruar duhet të paraqiten mostrat origjinale, sipas specifikimeve teknike në datën dhe orën e hapjes së ofertave. Dorëzimi i mostrave, do të bëhet pranë Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Tiranë, të mbyllura në një zarf kuti jo transparente të vulosur mbi të cilin të shënohet:

“Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vleresimit të Ofertave të procedurës së prokurimit me objekt “Shtypshkrime Mjeku (Regjistra të Mjekut)” dhe jo para datës 07.12.2021, ora 13:00.”

Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të paraqesë autorizimin përkatës për paraqitjen e tyre si dhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf kuti.

Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënoje Numrin Rendor të Artikullit që përfaqëson.

Nëse mostrat e dorëzuar, nuk janë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuara sipas Numrit Rendor, nëse ka mungesa mostrash për artikuj të vecantë, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe për pasojë ofertuesi do të skualifikohet.

Gjithashtu mosdorëzimi i këtyre mostrave në kohë përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik ofertues.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.”

III.2.1 Referuar Nenit 36, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se: “Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës

dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi. 2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. 3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën; b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve; c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj". 4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente". 5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente. 6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor."

Referuar nenit 77, pika 1 të ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 6 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndyshuar, kërkohet shprehimisht:

“Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”

III.2.2. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike, janë lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.2.3 Me vendimin nr. 1160/24 prot., datë 24.07.2023, protokolluar me tonën me nr. 1725/4 prot., datë 25.07.2023, të KSHA-së, autoriteti kontraktor nuk pranon ankesën e OE “Inpress” SHPK

III.2.4. Komisioni i Prokurimit Publik, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar pranë tij, si dhe ankesës e paraqitur në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Kristalina.KH” SHPK vëren, se pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues “Inpress” SHPK” kanë të bëjnë me kundërshtimin e vendimit të KVO-së në lidhje me plotësimin e specifikimeve teknike për mostrat e paraqitura.

Në kuadër të shqyrtimit administrativ të ankesës, në mënyrë sa më transparente dhe të drejtë Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se për sqarimin e fakteve kërkohen njohuri të posaçme teknike, kërkuar edhe nga ankimuesi dhe kryerja e veprimeve procedurale për realizimin e analizave/ekzaminimeve të gjendjes së mostrave të dorëzuara në kuadër të procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Komisioni i Prokurimit Publik, me qëllimin e kryerjes së procedurës së hetimit administrativ, lidhur me pretendimet e ngritura nga ankimuesit, i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dorëzojë pranë KPP-së, mostrat e paraqitura për këtë procedurë prokurimi nga operatori ekonomik “Kristalina-KH” SHPK si dhe dokumentacionin shoqëruar të tyre.

Më datë 29.08.2023, Komisioni i Prokurimit Publik mori Vendimin e ndërmjetëm me Nr. 830/2023 datë 29.08.2023 dhe nr. 1725/7 prot., “Mbi testimin e mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik “Kristalina-KH” SHPK, pranë laboratorit testues të akredituar “Eko-Studio-Projekt” SHPK:

1. *Të urdhërojë kryerjen e ekspertizës për ekzaminimin mostrave të paraqitura nga operatori ekonomik “Kristalina-KH” SHPK nga laboratorit i akredituar i shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me nr REF-72907-06-19-2023 me objekt “Shpenzime per Shtypshkrime te Regjistrave te Mjekut 2023” me fond limit 2,045,331.8 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 03.07.2023 nga autoriteti kontraktor Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.*
2. *Të testohen mostrat e operatori ekonomik “Kristalina-KH” SHPK:*
 1. *Regjistër i Vizitave të Mjekut të Përgjithshëm dhe Familjes Për Fëmijë–testim për gramaturën e kartonit dhe gramaturën e faqeve të brëndshme*
 2. *Regjistër i Regjistër i Vizitave të Mjekut të Përgjithshëm dhe Familjes për të Rritur – testim për gramaturën e kartonit dhe gramaturën e faqeve të brëndshme*
 3. *Regjistër i Urgjencës dhe Ndihmës së Shpejtë - testim për gramaturën e kartonit dhe gramaturën e faqeve të brëndshme*
 4. *Regjistër i Vizitave në Shtëpi - testim për gramaturën e kartonit dhe gramaturën e faqeve të brëndshme.*
 5. *Regjistër i Vizitave Obstetrikale - testim për gramaturën e kartonit dhe gramaturën e faqeve të brëndshme*
 6. *Regjistër i Vizitave Gjinekologjike - testim për gramaturën e kartonit dhe gramaturën e faqeve të brëndshme*
 7. *Regjistër i Vizitave të Urinës Komplet - testim për gramaturën e kartonit dhe gramaturën e faqeve të brëndshme*

8. *Regjistër i Analizave të Gjakut Komplet - testim për gramaturën e kartonit dhe gramaturën e faqeve të brëndshme*
 9. *Regjistër i Vizitave të Mjekut Specialist Ambulator - testim për gramaturën e kartonit dhe gramaturën e faqeve të brëndshme*
 10. *Regjistër i Vizitave të Mjekut të Konsultorit të Fëmijëve - testim për gramaturën e kartonit dhe gramaturën e faqeve të brëndshme*
 11. *Regjistër i Vizitave me Mami-Infermier për Shërbimin Nëna dhe Fëmija - testim për gramaturën e kartonit dhe gramaturën e faqeve të brëndshme*
 12. *Regjistër Hyrje – Dalje të Vaksinave - testim për gramaturën e kartonit dhe gramaturën e faqeve të brëndshme*
 13. *Regjistër Themeltar i Vaksinimit - testim për gramaturën e kartonit dhe gramaturën e faqeve të brëndshme*
 14. *Regjistër i Injeksioneve dhe Manipulimeve - testim për gramaturën e kartonit dhe gramaturën e faqeve të brëndshme*
 15. *Regjistër Depistimit të Grave për CA - testim për gramaturën e kartonit dhe gramaturën e faqeve të brëndshme*
 16. *Regjistër i Fletë Daljeve nga Depot Farmaceutike - testim për gramaturën e kartonit dhe gramaturën e faqeve të brëndshme.*
3. *Operatori ekonomik ankimues “Inpress” SHPK, të parapaguajë për llogari të shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, shumën prej 211 200 L pa TVSh sipas tarifave të përcaktuara me shkresën nr. 47/1 prot., datë 23.01.2023 protokolluar me tonën me nr. 2710/9 prot., datë 06.02.2023, për testimin e mostrave dhe të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit, brenda datës 04.09.2023 ora 10:00.*
 4. *Në orën 10.00 të datës 04.09.2023, të paraqiten pranë Komisionit të Prokurimit Publik përfaqësues të operatori ekonomik “Inpress” SHPK, “Kristalina-KH” SHPK si dhe përfaqësues nga autoriteti kontraktor, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor., për verifikimin e mostrave për të cilët ngrihen pretendimet.*
 5. *Më datë 04.09.2023 ora 11.00 përfaqësuesit e pranishëm në këtë seancë do të dorëzojnë mostrat për testim pranë laboratorit të shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK*
 6. *Të njoftojë laboratorin e shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK për kryerjen e testimit të mostrave që do të dorëzohen në datën 04.09.2023.*
 7. *Afati për kthimin e përgjigjes së testimit brenda 10 (dhjetë) ditëve punë, nga dita e nesërme e marrjes në dorëzim të mostrave.*
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”.

III.2.4.1. Më datë 04.09.2023 në vijim të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 830/2023 datë 29.08.2023, në prani të anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik u mbajt Seanca dëgjimore me pjesëmarrjen e të gjitha palëve, ku përfaqësuesit e “Kristalina-KH”

SHPK kryen verifikimet e mostrave të dorëzuara të cilat do të dorëzohen pranë laboratorit testues.

Përfaqësuesja e OE “Inpress” SHPK dorëzoi mandat-pagesën për testimet me nr. 1725/8 prot., datë 04.09.2023, për llogari të laboratorit testues “Eko-Studio-Projekt” SHPK.

Mostrave të dorëzuara iu vendosën kodet

<i>SPS-PS-716 (letra)</i>
<i>SPS-CBS-716 (kartoni)</i>
<i>SPS-PS-717 (letra)</i>
<i>SPS-CBS-717 (kartoni)</i>
<i>SPS-PS-718 (letra)</i>
<i>SPS-CBS-718 (kartoni)</i>
<i>SPS-PS-719 (letra)</i>
<i>SPS-CBS-719 (kartoni)</i>
<i>SPS-PS-720 (letra)</i>
<i>SPS-CBS-720 (kartoni)</i>
<i>SPS-PS-721 (letra)</i>
<i>SPS-CBS-721 (kartoni)</i>
<i>SPS-PS-722 (letra)</i>
<i>SPS-CBS-722 (kartoni)</i>
<i>SPS-PS-723 (letra)</i>
<i>SPS-CBS-723 (kartoni)</i>
<i>SPS-PS-724 (letra)</i>
<i>SPS-CBS-724 (kartoni)</i>
<i>SPS-PS-725 (letra)</i>
<i>SPS-CBS-725 (kartoni)</i>
<i>SPS-PS-726 (letra)</i>
<i>SPS-CBS-726 (kartoni)</i>
<i>SPS-PS-727 (letra)</i>
<i>SPS-CBS-727 (kartoni)</i>
<i>SPS-PS-728 (letra)</i>
<i>SPS-CBS-728 (kartoni)</i>
<i>SPS-PS-729 (letra)</i>
<i>SPS-CBS-729 (kartoni)</i>
<i>SPS-PS-730 (letra)</i>
<i>SPS-CBS-730 (kartoni)</i>
<i>SPS-PS-731 (letra)</i>
<i>SPS-CBS-731 (kartoni)</i>

III.2.5. Pranë Komisionit të Prokurimit Publik jnaë ë depozituar shkresat me nr. 716 prot., datë 14.09.2023, nr. 717 prot., datë 14.09.2023, nr. 718 prot., datë 14.09.2023, nr. 719 prot., datë 14.09.2023, nr. 720 prot., datë 14.09.2023, nr. 721 prot., datë 14.09.2023, nr. 722 prot., datë 14.09.2023, nr. 723 prot., datë 14.09.2023, nr. 724 prot., datë 14.09.2023, nr. 725 prot., datë 14.09.2023, nr. 726 prot., datë 14.09.2023, nr. 727 prot., datë 14.09.2023, nr. 728 prot., datë 14.09.2023, nr. 729 prot., datë 14.09.2023, nr. 730 prot., datë 14.09.2023, e Eko-Studio-

Projekt SHPK me anë të së cilës përcjell “Raport-Testim”, mbi rezultatet e testimit të mostrave për mostrat e operatorit ekonomik “Kristalina.KH” SHPK:

REZULTAET E LABORATORIT					
nr	MOSTRA ME KOD	EMERTIMI	REZULTATI	NUMRI I PROVES	DATA
1	SPS-PS-716 (letra)	Regjister i vizitave te mjekut te pergjithshem dhe familjes per femije	301,945 g/m ²	716	14/09/2023
	SPS-CBS-716 (kartoni)		59,835 g/m ²		14/09/2023
2	SPS-PS-717 (letra)	Regjister i vizitave te mjekut te pergjithshem dhe familjes per te rritur	299,831 g/m ²	717	14/09/2023
	SPS-CBS-717 (kartoni)		60,074 g/m ²		14/09/2023
3	SPS-PS-718 (letra)	Regjister i urgjences dhe ndihmes se shpejte	301.8484 /m ²	718	14/09/2023
	SPS-CBS-718 (kartoni)		63.048 g/m ²		14/09/2023
4	SPS-PS-719 (letra)	Regjister i vizitave ne shtepi	300.2538 /m ²	719	14/09/2023
	SPS-CBS-719 (kartoni)		63.815 g/m ²		14/09/2023
5	SPS-PS-720 (letra)	Regjister i vizitave obsentrikale	301.263 g/m ²	720	14/09/2023
	SPS-CBS-720 (kartoni)		63.256 g/m ²		14/09/2023
6	SPS-PS-721 (letra)	Regjister i vizitave gjinekologjike	300.239 g/m ²	721	14/09/2023
	SPS-CBS-721 (kartoni)		60.6344 g/m ²		14/09/2023
7	SPS-PS-722 (letra)	Regjister i analizave te urines komplet	300.0794 /m ²	722	14/09/2023
	SPS-CBS-722 (kartoni)		63.454 g/m ²		14/09/2023
8	SPS-PS-723 (letra)	Regjister i analizave te gjakut komplet	300.672 g/m ²	723	14/09/2023
	SPS-CBS-723 (kartoni)		63.720 g/m ²		14/09/2023
9	SPS-PS-724 (letra)	Regjister i vizitave te mjekut specialist ambulator	299.843 g/m ²	724	14/09/2023
	SPS-CBS-724 (kartoni)		62.3306 g/m ²		14/09/2023
10	SPS-PS-725 (letra)	Regjister i vizitave te mjekut te konsultorit te femijeve	301.11654 g/m ²	725	14/09/2023
	SPS-CBS-725 (kartoni)		59.525 g/m ²		14/09/2023
11	SPS-PS-726 (letra)	Regjister i vizitave me mami - infermier per sherbimin nena dhe femija	299.994 g/m ²	726	14/09/2023
	SPS-CBS-726 (kartoni)		62.956 g/m ²		14/09/2023
12	SPS-PS-727 (letra)	Regjister i hyrje -dalje te vaksinave	302.1814 g/m ²	727	14/09/2023
	SPS-CBS-727 (kartoni)		63.023 g/m ²		14/09/2023
13	SPS-PS-728 (letra)	Regjister themeltar i vaksinimit	301.233 g/m ²	728	14/09/2023
	SPS-CBS-728 (kartoni)		61.173 g/m ²		14/09/2023
14	SPS-PS-729 (letra)	Regjister i injeksioneve dhe manipulimeve	299.663 g/m ²	729	14/09/2023
	SPS-CBS-729 (kartoni)		61.763 g/m ²		14/09/2023
15	SPS-PS-730 (letra)	Regjister i depistimit te grave mbi 35 vjec me ca gjiri	299.555 g/m ²	730	14/09/2023
	SPS-CBS-730 (kartoni)		59.895 g/m ²		14/09/2023
16	SPS-PS-731 (letra)	Regjister flet daljeve nga depot farmaceutike	303.743 g/m ²	731	14/09/2023
	SPS-CBS-731 (kartoni)		60.752 g/m ²		14/09/2023

III.2.6. Referuar të dhënave të testimeve të kryera, të paraqitura në tabelë përmbledhëse përbri specifikimeve teknike, Komisioni vëren, se të dhënat nga Raport Testimi kanë diferenca për sa i përket gramaturës së artikujve 1-11 dhe 14-18 të tabelës për kampionet me kod **Përkatese** që i përket operatorit ekonomik “Kristalina.KH” SHPK, duke plotësuar specifikimet teknike në lidhje me gramaturën e kartonit dhe të letrës për artikujt 1-11 dhe 14-18.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, ndërsa ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i

interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik, që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Mostrat e kërkuara në një procedurë prokurimi, referuar legjislacionit në fuqi, i shërbejnë autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të prodhuar produktin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

Akoma më tej, duke marrë parasysh edhe marzhin e gabimit të aparatit, i cili është 0.1g. gabim i pranueshëm, cituar në raport testimet e laboratorit “Eko-Studio-Projekt” SHPK, vlerat e gramaturës jo vetëm arrijnë të kapin minimumin e vlerave të kërkuara nga autoriteti kontraktor për artikujt objekt-ankimi por edhe i tejkalojnë ato.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se mostrat e artikujve të dorëzuara nga operatori ekonomik “Kristalina-KH” SHPK, bazuar në të dhënat e testeve të kryera në lidhje me gamaturën e kartonit dhe të letrës, përmbushin specifikimet teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

Për sa më lart, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK nuk qëndrojnë.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK, se: “Së Treti, Ne kemi bindjen, që OE Kristalina KH shpk. nuk ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 7 të DST, si dhe jo në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 2.1.a. “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, të DST...”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 8 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të dokumentave të tenderit të modifikuar rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar si vijon:

“Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)
FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-

Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

• **I
n
f
o**

Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

<i>etj.</i>				
<i>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</i>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<i>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</i>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<i>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</i>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<i>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</i>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<i>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</i>				
<i>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</i>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<i>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</i>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<i>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</i>				
<i>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutuar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</i>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

- 1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;*
- 2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i*

kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;

3. *Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;*
4. *Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;*
5. *Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala "konkurrentë" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:*
 - a) *paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;*
 - b) *është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.*
6. *Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):*
 - a) *Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;*
 - b) *Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).*
7. *Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:*
 - a) *çmimet ;*
 - b) *metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;*
 - c) *qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,*
 - d) *paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.*
8. *Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).*
9. *Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).*

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

*Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:
Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.*

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarë siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, Zëvendësministrit, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektorët e Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit të Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut I të seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin në të cilin zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, në përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: _____ <u>Profili i punonjësve</u> _____ <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: _____

Emri, Mbiemri _____
Firma _____
Vula _____
Data e dorëzimit të deklaratës _____

Ju lutemi sigurohuni që:

- *Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.*
- *Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.*
- *Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.*
- *Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.*

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- *Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.*
- *Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.”.*

III.3.2. Në shtojcën 7 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

“Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
 - b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
 - c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
 - ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
 - d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
 - dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
 - e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
 - f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
 - g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
 - gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
 - h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
 - i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.
- Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.
- Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.
- Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**
- Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.
- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :
- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.”

III.3.3. Nga shqyrtimi i ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Kristalina.KH” SHPK, lidhur me përmbushjen e kriterit të sipërpërmendur rezulton se është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:

1. Shtojca 8 “Formular përmbledhës i vetëdeklarimit”, datë 03.07.2021.

III.3.4. Në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

- a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- d) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- e) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- f) falsifikim;
- g) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve

a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;

b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit;

c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;

ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;

b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja “ç”, të këtij ligji;

c) operatori ekonomik është shpallur fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;

d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;

e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate, për të cilën është përjashtuar sipas parashikimeve në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji.

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;

f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.

g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.

5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.

6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim. Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një veprë penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera. Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.
7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit apo koncesionit, nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.

III.3.5. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit.

Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër i ka këto dokumente.

4. Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

5. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë:

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit kontraktor duhet të jenë në origjinal ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

Rregulla të posaçme për këtë pikë parashikohen në rregullat e prokurimit publik.”.

III.3.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Agjencia Prokurimit Publik me Vendimin nr. 10, datë 05.10.2022 Për Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në dokumentet standarde të tenderit për mallra, punë, shërbime për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e thjeshtuar”, në pikën 3 të tij përcaktohet se: 3. Në çdo set të DST për mallra, punë, shërbime ndryshohet “*Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit*” sipas formatit bashkëlidhur këtij vendimi, i cili bëhet pjesë e seteve, për këtë lloj procedure”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, procedura e prokurimit objekt-shqyrtimi është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike nga ana e Autoriteti Kontraktor më datë 20.06.2023. Nga verifikimi i dokumenteve standarde të publikuara nga autoriteti kontraktor konstatohet, se ky i fundit ka publikuar setin e dokumentave standarde për procedurën e prokurimit Procedurë e Hapur e thjeshtuar, sipas vendimit nr. 10, datë 05.10.2022, me ndryshimet përkatëse konkretisht dhe të shtojcës 8 “*Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit*”, në të cilin konstatohen ndryshime thelbësore edhe në përmbajtje të tij.

Në përmbushje të kriterit të parashikuar në shtojcën 7 “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*”, pika 2/1.a Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST-së, operatori ekonomik “Kristalina.KH” SHPK në përmbushje të këtij kriteri ka ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik Shtojcën 8 “*Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit*”, nga verifikimi i të cilit konstatohen përputhje në formë edhe në përmbajtje me ndryshimet e bëra nga ana e Agjencisë Prokurimit Publik me vendimin nr. 10, datë 05.10.2022, të “*Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit*”.

Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “Kristalina.KH” SHPK plotësojnë kriterin e veçantë të kualifikimit, pasi ka paraqitur shtojcën 8 sipas kërkesës në pikën 2/1.a të shtojcës 7 “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, pjesë e dokumentave të tenderit.

Për sa më lart, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Inpress” SHPK nuk qëndrojnë

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “*Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të

Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Inpres” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar,” me nr REF-72907-06-19-2023 me objekt “Shpenzime për Shtypshkrime të Regjistrave të Mjekut 2023” me fond limit 2,045,331.8 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 03.07.2023 nga autoriteti kontraktor Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro